



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1161 / prot.

Elbasan, më 14.05.2024

VENDIM

Nr. 30, datë 14.05.2024

PËR SHPALLJEN E APLIKIMEVE PËR ANËTARË NË KOMISIONIN INSTITUCIONAL TË ZGJEDHJEVE DHE NË KOMISIONIN E APELIMIT NË UNIVERSITETIN E ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Urdhrin e MAS nr.101, datë 13.03.2024 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet publike të arsimit të lartë", nenin 37, pika 2 e Rregullores së zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Senati Akademik,

Vendosi:

1. Të shpallë hapjen e procesit të aplikimeve për anëtarë në Komisionin Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) dhe anëtarë në Komisionin e Apelimit (KA) në Univesitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".
 2. Të drejtën për të aplikuar në KIZ e kanë individët që plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) Janë personel akademik me kohë të plotë në Univesitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani;
 - b) Janë studentë në Univesitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".
 - c) Nuk kanë qenë asnjëherë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;
 3. Të drejtën për të aplikuar në KA e kanë individët që plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) Kanë përvojë pune në mësimdhënie, jo më pak se 5 vjet, me kohë të plotë;
 - b) Nuk kanë qenë asnjëherë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;
 4. Afati i fundit i dorëzimit të dokumenteve për aplikim për anëtar i KIZ dhe KA në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", do të jetë data 16.05.2024, ora 15.00.
 5. Të interesuarit duhet të dorëzojnë pranë Sekretarisë së Senatit Akademik dokumentacionin e aplikimit sipas formularëve bashkëngjitur këtij vendimi.
- "Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Univesitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Skender TOPI